

**MUHARREM GASHI**

**RRETH DISA DUKURIVE FONETIKE TË SË FOLMES  
SË QYTETIT TË PRIZRENIT ME RRETHINË**

**Hyrje**

Dialektet dhe të folmet a ligjërimet vendore të shqipes, sidomos për sa lidhet me pasurinë leksikore dhe frazeologjike, natyrisht edhe të trajtave e ndërrimeve fonetike dhe të tipareve morfosintaksore të tyre në përgjithësi, bashkë me emrat e vendeve dhe të njerëzve, kanë qenë dhe vijojnë të jenë fusha kërkimi shumë të pëlleshme, prej nga mund të sillen të dhëna e faktime me vlerë edhe për studime të tjera gjuhësore, sidomos për marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje, po edhe për dukuri të moçme fonetike, leksikore dhe për fjalëformimin e shqipes. Fjalët dialektore dhe krahinore janë burim i pasur në fondin leksikor të gjuhës shqipe, vlera dhe rëndësia e tyre është e madhe në sistemin leksikor të saj. Përimtuesit dhe studiuesit e shquar të gjuhës shqipe, sidomos që nga Rilindja, kanë treguar kujdes të madh për fjalët e shprehjet e popullit tonë. Puna e nisur nga Fran Bardhi do të përvijohet nga K. Kristoforidhi dhe nxënësi i tij i shquar, Aleksandër Xhuvani dhe shumë të tjerë pas tyre. Pas Luftës së Dytë Botërore nisin studime përkushtuese nga institucionet tona arsimore e edukative, nga edhe kemi studime me kritere shkencore, ndonëse edhe këto nuk kishin përvojën e duhur të shkencave përëndimore. Njohja dhe përimtimi i vlerave gjuhësore të së folmes së qytetit të Prizrenit me rrethinë na kanë tërhequr vëmendjen qysh prej disa vitesh nga dhe kemi shkruar disa herë për to. Së pari, në punimin e magjistraturës me titull “Studimet dialektologjike në Kosovë-rezultate e probleme” dhe, më vonë, po edhe më gjerë e në mënyrë më të shtjelluar, në studimin e doktoratës: “E folmja e Prizrenit me rrethinë”, tezë doktorate e mbrojtur në QSA, Tiranë, në vitin 2014.

**Metodologjia**

Duke qenë se punimi pasqyron një shpërfaqje të shkurtër të një teme më të gjerë trajtuese gjithsesi se analiza e përqendrimi në tryezë të punës, në radhë të parë ka shteruar studimet dialektologjike të të folmeve të qytetit të Prizrenit, pastaj punimet studimore e monografite e të folmeve të rrethinës së qytetit të Prizrenit. Në bosht të këtij shqyrtimi kemi tërhequr një paralele të këtyre të folmeve në krahasim me rezultatet e Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe. Nga pikat më të arsyeshme e kemi parë arealin e të folmes së Hasit, përkatësisht fshatin Zym të kësaj treve ku banorët janë të besimit katolik dhe

atij mysliman. Ndërsa pikë tjetër krahasuese me të arriturat e rezultateve të dialektologjisë shqiptare kemi përzgjedhur Korishën, vendbanim që i përket arealit të të folmes së Rrethit të Bjeshkës së Kabashit të Prizrenit. Për të qenë sa më përfaqësuese këto karakteristika të këtyre pikë vështrimeve që i dallojnë apo edhe i tipizojnë aspektet e tyre të përbashkëta në këto mjedise më është dashur të bëj një numër vizitash hulumtuese. Tutje për të qenë në kufijtë e perceptimit përkushtues të materialit gjuhësor të vëzhguar, kam përzgjedhur edhe pika të tjera që ta paraqes sa më dëftuese dukurinë. Përveç identifikimeve përgjegjëse, në disa mjedise, për të ardhur deri te vlerësimet e duhura kam shkuar më shumë herë.

Anketimet në terren, si dhe shqyrtimi e njohja nga afër e studimeve dhe shkrimeve të ndryshme të bëra para nesh, na japin mundësinë të bindemi se Prizreni dhe rrethina e tij ofron një mozaik ligjërimor të vlershëm e shumë dëftues, jo vetëm në aspektin e studimit dialektologjik të mirëfilltë, por edhe më gjerë për dukuri me vlerë etnolinguistike e sociolinguistike etj. Studimi ynë është i gjerë dhe ka kapur kahe e dukuri të shumta, por prej tyre veçohet e folmja e Grykës së Lumbardhit të Prizrenit, e cila paraqitet me interes nga dhe e kemi trajtuar në mënyrë të posaçme për shkak të strukturës së popullsisë së saj, përbërjes etnike, ndërsa e folmja e Vërrinit, për karakteristikat e përafërta me të folmen e qytetit të Prizrenit, me atë të së folmes së Zhurit si dhe atë të fshatit Shtrungë (Struzhje) të Malësisë së Vërrinit të Prizrenit. Studimi, pa marrë parasysh se visari i saj dialektologjik është prekur edhe më herët, sjell shtjellime e një pamje të gjerë, relativisht të plotë të së folmes, po edhe të kaheve e prirjeve zhvillimore të sotme të saj, sipas ideimit dhe udhëzimeve të mentorit tim, prof. Gjovalin Shkurtajt, që na ka udhëhequr e përudhur në hartimin e punimit tonë të doktoratës.

Së pari, po edhe si boshti kryesor i shqyrtimeve tona veçohet puna dhe njohja që ishte siguruar edhe nga studimet e mëparshme dhe, mbi bazën e në mbështetje të tyre, kemi ndërmarrë gjurmimin e mëtejshëm të fjalëve e shprehjeve popullore, duke bërë edhe përqasjen e krahasimin me të dhënat e studimeve për trojet dhe viset shqiptare si në Kosovë, Malit të Zi, Maqedoni e kudo jashtë trojeve etnike. Gjatë të gjitha shqyrtimeve tona, si në ndjekjen e materialit burimor, ashtu edhe në qëmtimin e lëndës në botimet e mëpërshme, kemi pasur si postulat se lënda e mbledhur nga gurra popullore është ushqimi bazë i pasurisë sonë leksikore dhe gjithashtu përvijohet se kështu edhe sistemohet në fondin e leksikut e të frazeologjisë së gjuhës shqipe, ngase edhe ky mes, siç thotë edhe akad. J. Thomai<sup>1</sup> ka shprehje të një gjuhe të pasur, të bukur, të fuqishme e emocionuese.

Mbledhja e tyre drejtpërdrejt nga goja e popullit është detyrë e dorës së parë, sepse lidhet me jetën dhe veprimtarinë e njerëzve, me punën, doket,

<sup>1</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2011, f. 234.

zakonet, traditën, psikologjinë dhe mjedisin ku ata jetojnë ngase vlerat e fjalëve, sikundër theksonte prof. A. Kostallari *jetojnë e veprojnë në gjirin e popullit tonë dhe të gjuhës sonë kombëtare*<sup>2</sup>. Kjo prurje shquhet me shumë interes si për nga hapësira, ashtu edhe për nga vlera lëndë e së folmes së arealeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij.

Në kundrimin e tipareve dialektore dhe të prirjeve zhvillimore të së folmes së Prizrenit me rrethinë, ishte e natyrshme dhe e ligjshme të konsideronim dhe të përfillnim në masën e nevojshme prurjet konkrete, përgjithshme gjuhësore dhe sidomos lëndën e gjerë leksikore që kishin sjellë para nesh një numër artikujsh e punimesh kushtuar të folmeve verilindore e më tej, si: *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*<sup>3</sup>, *E folmja e Hasit*<sup>4</sup>, *Vëzhgime gjuhësore dhe etnografike të zonës verilindore të Shqipërisë dhe të Rrafshit të Dukagjinit (Kosovë)*<sup>5</sup>, *Fjalor i fjalëve të rralla të përdorura në viset shqiptare të Maqedonisë*<sup>6</sup>, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*<sup>7</sup>, *Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës*<sup>8</sup> etj.

Mbi bazën e tipareve, që gjithsesi janë karakteristike të përbashkëta edhe për mbarë gegërishten verilindore, e folmja e Prizrenit me rrethinë përcaktohet në të folmet e gegërishtes verilindore për të cilat kishin shkruar dialektologët kosovarë (I. Ajeti, R. Ismajli, I. Badallaj) po edhe ishin vënë re e përfshirë në studimet përgjithësuese të J. Gjinarit, B. Becit e të tjerë, si për shembull: diftongjet *ae* e *oe* kanë dhënë *â*, *ô* (*thâ* < *thâe*, *vô* < *vôe*); grupet e vjetra *kl* e *gl* janë rrudhur në *k* e *g*: *kâj* “qaj”, *kumësht* “qumësht”, *ke* “qe”, *gû-ni* “gju-ri”, *i gâtë* “i gjatë”; fonema *k* është e pranishme te fjalët: *kep* “qep”, *kelb* “qelb”; emrat mashkullorë që mbarojnë me *k*, *g* e *h*, kur shquhen marrin mbaresën *i*: *miki* (miku), *zogi* (zogu), *krahi* (krahu), *ahi* (ahu). Koha e pakryer formohet nga tema e pjesores me mbaresat *-shna* (*-jshna*) për vetën e parë njëjës (*ardhshna*, *dalshna*, *kapshna*, *shkojshna*) dhe *-ke* (*-jke*), për vetën e tretë njëjës (*ardhke*, *shkojke*); e kryera e dëftores të foljet jokalimtare formohet me foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* dhe me pjesoret e foljes: *jam ardh*, *jam dal*, *jam kâ<sup>o</sup>n*, *a kâ<sup>o</sup>n*.

Tiparet e përimtuara nga studimet pararendëse, si dhe korpusi i lëndës që kemi sjellë në studimin tonë nga arealet e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës, janë

<sup>2</sup> A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës...*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1982/2, f. 11.

<sup>3</sup> Shih, J. Gjinari, *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, Tiranë, 1963.

<sup>4</sup> I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001.

<sup>5</sup> P. Zeneli, *Vëzhgime gjuhësore dhe etnografike*, Tiranë, 2010.

<sup>6</sup> Q. Murati, *Fjalor i shqipes truallsore të Maqedonisë*, Tetovë, 1998.

<sup>7</sup> M. Ahmetaj, *Fjalor i të folmeve shqiptare në Mal të Zi*, Prishtinë 1996.

<sup>8</sup> A. Sula, *Visare gjuhësore-kulturore nga Malësia e Gjakovës*, Tiranë, 2002.

kundruar e përqsaur duke iu përmbajtur një metode studimore që mbështet edhe në karakteristikat e përgjithshme të zhvillimeve gjuhësore të këtyre të folmeve, duke i krahasuar elementet qenësore edhe me rezultatet e pasqyruara në hartat e “Atlasit Dialektologjik të Gjuhës Shqipe”, vepër madhore e gjuhësisë shqiptare, pastaj të folmeve fqinje si ajo e Rahovecit, ajo e Opojës etj. Në kuadër të anketimeve dhe hartografimeve në këtë vepër janë pasur parasysh edhe pikat e të folmeve të Kosovës, pra edhe të arealit tonë të Prizrenit me rrethinë<sup>9</sup>.

Anketimet dhe materiali i mbledhur për nxjerrjen e dukurive kryesore fonetike dhe morfologjike të së folmes është bërë duke zgjedhur edhe disa pika që na janë dukur më përfaqësimitare të këtyre arealeve, si fshati **Zym** i Hasit, **Korisha** si e folme që paraqet tiparet e së folmes së Rrethit të Bjeshkës së Kabashit të Prizrenit, po kemi hetuar edhe në pika të tjera, si në Rrethin e Bjeshkës së Sharrit, **Mushnikova**, si përfaqësuese më tipike e të folmes së Grykës së Lumbardhit të Prizrenit.

Hulumtimet dhe ndihmesat e para për njohjen e të folmeve të kësaj zone i kanë bërë një varg studiuesish, në fillim, albanologë të huaj, si N. Jokli<sup>10</sup>, J. Thunmanne<sup>11</sup>, H. Pedersen, G. Vajgandi, N. Jokli, F. Mikloshiq<sup>12</sup>, C. Tagliavini<sup>13</sup>, M. Lamberci<sup>14</sup> etj. për të cilët njohja e gjuhës shqipe ishte kryesore, prandaj edhe janë trajtuar më shumë tiparet dhe vlerat gjuhësore me karakter më të përgjithshëm, kurse më pak janë prekur tiparet e imta me vlerë për dialektologjisë.

Në këtë kontekst kanë qenë edhe të dhënat për të folmet e arealit tonë, që dalin nga veprat e botuara të shkrimtarëve me origjinë nga trevat verilindore, sidomos të P. Bogdanit<sup>15</sup>, P. Budit, kurse të dhënat mirëfilli me vlerë dialektologjike do t'i kishim vetëm më vonë në studimet e I. Ajetit<sup>16</sup>, H.

<sup>9</sup> Shih: *Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Vëllimi I, Napoli, 2007, Vëllimi II, Napoli 2008.

<sup>10</sup> N. Jokli, *Njoftim ... Komisionit Ballkanik të Akademisë Perandorake të Shkencave në Vjenë*, 1915.

<sup>11</sup> J. Thunmanne, *Hulumtime mbi historinë e popujve të Evropës Lindore*, Lajpcig, 1774.

<sup>12</sup> F. Mikloshiq, *Kërkime të gjuhës shqipe*, 1870.

<sup>13</sup> C. Tagliavini, *Të folmet shqipe të tipit të gegërishtes lindore (Dardania dhe Maqedonia)*.

<sup>14</sup> M. Lambertzi, I. Teil, *Grammatik und albanische Texte*, “Albanisches Lesebuch”, I. Leipzig, 1948.

<sup>15</sup> P. Bogdani, “*Cuneus Prophetarum* (=“Çeta e profetëve”), Pietro Bogdano (= e Pjetër Bogdanit), PATAVII MDCLXXXV (=Padovë, 1685), botuar nga Dr. Rudolf Trofenik, München, 1977.

<sup>16</sup> I. Ajeti, *Rreth disa tipareve gjuhësore të ligjërimeve shqiptare të Kosovës*, GJA, 2-1969, Prishtinë, 1969.

Aganit<sup>17</sup> etj., në shkrimet e të cilëve do të shquhen kundrimet rreth leksikut, aspekteve sintaksore, si dhe për disa nga dukuritë që spikasin veçohet kalimi i ë-së në **a**, i ë-së në **u** në prapashtesat **-shëm** dhe **-llëk**, përdorimi i **ll**-së në vend të **dh**-së, rënien e fonemës së shtegut të faringut **h** në të tri pozicionet e fjalës, i bashkëtingëlloreve **r** e **rr** (si për shembull, në Rahovec dëgjohe vetëm **r**), e ndonjë element tjetër etj.

Në vijim, në rrjedhë të viteve, tiparet dhe veçoritë dialektologjike të folmeve të Prizrenit me rrethinë do të pasqyrohen në një numër studimesh, ku veçohen punimet relativisht të gjera të V. Topçiu<sup>18</sup>, M. Topallit<sup>19</sup>, G. Luboteni<sup>20</sup>, M. Bardhit<sup>21</sup>, I. Badallajt<sup>22</sup>, A. Zymberit<sup>23</sup>, M. Halimit<sup>24</sup>, N. Pajazitit<sup>25</sup> dhe, tashti së mbrami edhe monografia e Fridrik Dulajt për të folmen e Rahovecit me rrethinë<sup>26</sup> dhe ndonjë tjetër. Këto punimet për të folmet e qytetit të Prizrenit me rrethinë e plotësojnë gjeografinë gjuhësore të të folmeve të gegërishtes verilindore, po edhe më gjerë të të folmeve shqipe, duke u bërë edhe mbështetje e trajtesave përgjithësuese të dialektologjisë sonë. Madje një numër sosh shquajnë arritje të kohës edhe për të folmet e kësaj treve, si për shembull: *Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës, në fillim të shekullit XIX*<sup>27</sup>, *E folmja e Hasit*<sup>28</sup>, *E folmja e Kabashit*<sup>29</sup> etj.

Me rëndësi në studimet dhe përgjithësimet kushtuar të folmeve të Prizrenit me rrethinë, ashtu si edhe në të folmet e tjera të të folmeve verilindore, sjellin edhe emërvende (toponime) me vlerë dëshmuese të

<sup>17</sup> H. Agani, *Rreth kategorive gramatikore të gjinisë të numrit dhe të rasës së emrit në të folmen e qytetit të Gjakovës*, SGJ, I, (Dialektologji), Prishtinë, 1978.

<sup>18</sup> V. Topçiu, *Veçoritë fonetike të së folmes së elementit katolik të qytetit të Prizrenit*, FF të UP, Prishtinë, 1978.

<sup>19</sup> M. Topalli, *Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit*, FF i UP, Dega e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1980.

<sup>20</sup> G. Luboteni, *Ndryshimet më të qenësishme dialektore ndërmjet gegnishtes dhe toskënishtes*, "Përparimi", X, Prishtinë, 1960.

<sup>21</sup> M. Bardhi, *Disa veçori karakteristike në vokalizmin e së folmes së Hasit*, SGJ, II, (Dialektologji), Prishtinë, 1979.

<sup>22</sup> I. Badallaj, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, GJASSHF, V-1975, Prishtinë, 1976.

<sup>23</sup> A. Zymberi, *Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit*, SNGJLKSH, 2, Prishtinë, 1978.

<sup>24</sup> M. Halimi, *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985.

<sup>25</sup> N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008.

<sup>26</sup> F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit*, Prishtinë, 2016.

<sup>27</sup> I. Ajeti, *Dokumenti më i vjetër i së folmes shqipe të Kosovës me alfabet arab*, I-1962, Prishtinë, 1962.

<sup>28</sup> I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005.

<sup>29</sup> M. Halimi, *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985.

hershmerisë dhe të autoktonisë që në kohën e hershme, sikundër janë, ndër të tjera, emërtimet: *Drini i Bardhë, Sharr, Therandë*, pastaj fjalët e moçme shqipe, si: *bujk, ujk, dardhë* etj., përkrah emërtimeve të qyteteve *Nishi, Shkupi, Lipjani*. Emri i lashtë i arealeve të këtyre të folmeve është *Dardania*, që shpjegohet sipas parimeve të fonetikës shqipe, pra me fjalën shqipe *dardhë*, duke përfaqësuar identifikimin e korpusit gjuhësor të toponimisë sonë të lashtë ilire. Madje siç dihet treva e Dardanisë deri në shekullin XIII nuk qe nën ndikimin sllav, kështu që deri në shekullin XIX, ky territor i *Dardanisë* njihej me këtë emër.

Pozita gjeografike e Prizrenit dhe rrethinës së tij është e rëndësishme ngase këtë e shquan *korridori* i rrugëve që e lidhin brendësinë e Gadishullit Ballkanik me daljen në Detin Adriatik. Këtë trevë e ka përrshkuar edhe rruga e njohur *Via Egnatia*. Territorin gjeografik të këtyre arealeve e shquajnë qytete, fshatra, fusha, fushëgropa, rrethe, male, maja, sheshe, komplekse, lumenj, pellgje, pllaja, përrenj, ura, kroje, kala, si p.sh.: Prizren, Romaja, Vlashnja, Fusha e Prizrenit, Rrethi i Bjeshkës së Sharrit, Mali i Pashtrikut, Maja e Cylenit, Sheshi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Kompleksi i Marshit, Lumbardhi i Prizrenit, Pellgu i Lumbardhit të Prizrenit, Pllaja e Prevallës, Përroi i Pashaçeshmës, Ura e Gurit, Kroi i Suzi Çelebisë, Kalaja e Prizrenit etj.

Një pjesë të rëndësishme të shqyrtimeve tona për të folmen e Prizrenit me rrethinë e përbën trajtesa që ka si bosht: *E folmja e qytetit të Prizrenit dhe e rrethinës së tij në krahasim me hartat e ADGJSH-së*. Në këtë vepër madhore që është fryt i një pune shumëvjeçare të një ekipi studiuesish të njohur (J. Gjinari, B. Beci, Gj. Shkurtaç, Xh. Gosturani) të folmet e arealeve të Prizrenit me rrethinë, të përfaqësuara me materialet e mbledhura në pikat **Nishor** (31/A) e rrafshit të Dukagjinit, **Zym** (37) e krahinës së Rrafshit të Dukagjinit, **Korishë** (38) e krahinës Hasi Gurit, **Reçan** (42) e krahinës së Rrafshit të Dukagjinit, prandaj edhe hartat e Atlasit kanë qenë për ne një mundësi më e mirë për ta shtrirë analizën e të dhënave të mbledhura në terren prej nesh, në një krahasim edhe me situatën e paraqitur në izoglosat e kësaj vepre, pa dyshim nga ato që paraqesin interes të rëndësishëm për studimet dialektologjike si dhe për trajtimet etnolinguistike të shqipes<sup>30</sup>. Me sa ka qenë e mundshme, në nxjerrjen e tipareve fonetike e morfologjike të së folmes së Prizrenit me rrethinë, u jemi referuar edhe të folmeve të tjera të gegërishtes verilindore, sidomos të atyre që janë edhe gjeografikisht më të afërta me këtë zonë, si me Xërxën (pika 35 në ADGJSH) e krahinës së Rahovecit, me të dhënat e krahinave të Junikut (pika 32 në ADGJSH), të Gjakovës (pika 34 në ADGJSH), si dhe me pikat e tjera, që vetë dukuritë e hartografuara në Atlas na imponojnë t'i konsiderojmë e të bëjmë edhe krahasimet e mundshme. Për të pasur një pamje sa më të qartë të

<sup>30</sup> M. Domi, *Parathënie* në “Atlasi Dialektologjik i Gjuhës Shqipe”, ASHSH, IGJL, Vëllimi I, Napoli, 2007, f. 10.

tipareve të së folmes së Prizrenit e rrethinave në kuadrin e ndarjes dhe përndarjes së dukurive më kryesore të tyre kemi ndjekur tipologjinë e ndjekur në ADGJSH, d.m.th. jemi nisur nga forma përfaqësuese në shqipen standarde, duke parë, kështu, pikëtakimet dhe dallimet e duke iu përmbajtur po asaj radhe të paraqitjes.

Në këtë mënyrë, në lëmin e fonetikës, na del kjo gjendje:

**1. Gjatësia e zanoreve të theksuara.** E folmja e Prizrenit e ruan dallimin midis të gjatave dhe të shkurtrave, njësoj ose pothuajse njësoj me të folmet e tjera të gegërishtes. si p.sh., fjala *plak* (m.) *pla:k* (f.), *vesh* (nj.) *-ve:sh* (sh.); *hâ°n* (folje) *-hâ°n* (hëna), *krÿm* (emër m. nj.) *-krÿ:m* (folje në pjesore), p.sh. *â krÿ:m!* (është krimbur). Me sa na rezulton, këtë situatë të dallimit të gjatësisë së zanoreve paraqesin edhe fjalët *lu:g* (lugë) - *lug* (lugu), *bën* (veta e tretë njëjës e kohës së tashme) *-bë:n* (veta e tretë sh. e së kryerës së thjeshtë), por na duket se kanë të njëjtën gjatësi format e fjalës *lot* (nj.) dhe *lot* (sh.).<sup>31</sup> Me rëndësi për t'u theksuar është edhe fakti se ky tipar dallues i rëndësishëm fonetik i së folmes së Prizrenit, ishte përshkruar e na del si i tillë edhe në disa prej studimeve të mëhershme, para se të ndërmerrnim punimin tonë, sidomos në punimin e V. Topçiu (i vitit 1978), kushtuar veçorive fonetike të së folmes së elementit katolik të qytetit të Prizrenit<sup>32</sup> dhe të M. Topallit (1980), që i kushtohet sistemit fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit<sup>33</sup>.

**2. Hundorësia e zanoreve.** Ashtu si dihet, edhe kjo e folme e ka dallimin e zanoreve të theksuara sipas tiparit të hundorësisë dhe kjo, jo vetëm kur zanoret ndiqen nga bashkëtingëlloret hundore *m*, *n*, *nj* si p.sh. *nân*, *mâlli*, *sêni*, *hûmi* etj., por ndonjëherë edhe të pandjekura nga bashkëtingëlloret hundore, si për shembull: *u frÿ:*, *kusÿ:*, *gllÿ: shkûn me thÿ: kollomoçin* etj. Edhe për këtë dukuri përqaşa dhe kundrimi krahasues me izoglosat e ADGJSH-së, gjithashtu nxjerr se edhe në këtë tipar të hundorësisë së zanoreve të theksuara, Prizreni me rrethinë përfshihet në arealin ruajtës, ku ndeshim me hundorësi fjalët e përfshira në Atlas e pikërisht: *me bâ*, *bâj*, *bân*, *m'u pî kâma* (m'u mpi këmba), *sÿ*, *kam dÿ sÿ n ball*; *sÿt e ballit*; *hû*, *me hûj*, *duhet me ia vû dÿ hûj* etj.<sup>34</sup>

Dukuria fonetike e *hundorësisë* e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës së tij duket se ka qenë një tipar i hershëm i shqipes së Veriut, sikundër edhe na dëshmohej që te autorët e vjetër, prej të cilëve më përfaqësimitare për arealin në fjalë mund të shihet vepra e Pjetër Bogdanit, porse nëse dukuria qartazi duket se është e moçme, nuk ka një kufi të prerë të pasqyrimin të saj.

<sup>31</sup> Shih: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, hartat 1.a, 1b, 1.c, 1ç, 1 d, 1dh, f.69-70.

<sup>32</sup> Shih, V. Topçiu, *Veçoritë fonetike të së folmes së elementit katolik të qytetit të Prizrenit*, UP, Prishtinë, 1978.

<sup>33</sup> Shih, M. Topalli, *Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit*, FF i UP, Dega e Gjuhës shqipe, Prishtinë, 1980.

<sup>34</sup> Shih: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, hartat 2.e, 2.c, 2ç, 2 d, f.76-80.

Fjalët që shquhen për hundorësi P. Bogdani i ka shkruar duke vënë si tregues të kësaj dukurie një *n* epentetike: *u banft, ansht, shtanzë*, ndërsa përemrat dëftorë *ai* dhe *ky* në rasën kallëzore dalin: *atan, këtan* etj.<sup>35</sup> Dukuria shquhet në studimin e I. Ajetit “Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës, në fillim të shekullit XIX”, Prishtinë, 1985, Prishtinë, 1978, ku ndeshim shembujt: *âsht, bân, sênd* etj. Kjo dukuri vijon të dokumentohet edhe në të folmen e Hasit, atë të Kabashit e atë të Anadrinit etj. Këto të folme kanë një sistem zanoresh hundore të përbërë prej këtyre njësisve fonetike: *â, ê, ô, û, î, dhe ý*. Timbri i rezonancës zanore është më i qartë kur ato qëndrojnë përpara bashkëtingëlloreve të tingullta (sonante): **m, n** e **nj**, ndërsa më i lartë kur ndodhen në mes të dy bashkëtingëlloreve hundore, si për shembull: *mê:ni mâ:n* etj. Me hundorësi nuk del zanorja *o*, ndërsa zanorja *y* hetohet mjaft pak e nazalizuar, si p.sh: në të folmen e Zhurit. Rezonanca hundore nuk është e barabartë, intensiteti i fonemave hundore është më i theksuar në arealet e të folmeve të Hasit në krahasim me të folmen e Anadrinit<sup>36</sup>. Lidhur me praninë (përkatësisht mungesën) e *o*-së hundore nëpër disa të folme të gegërishtes, mbështesim mendimin e I. Badallajt, i cili për të folmet e arealit të Prizrenit me rrethinë shprehet se, së paku në të folmen e Hasit etj. që i ka përshkruar ai, është “rezultat i evolimit të *a*-së hundore, që shkon drejt *o*-së, derisa me atë rrafshohet krejtësisht, p.sh: *âsht > â°sht > ôsht, kam bâ > kam bâ° > kam bô, nâna > nâ°na > nôna*<sup>37</sup> etj. Po kështu veçon edhe L. Mulaku për të folmen e Shalës së Bajgorës (f. 46) si dhe konstaton një timbër të hollë të *o*-së hundore, duke shtuar se ky timbër është i përfutur nga labializimi i zanores *â* hundore, d.m.th. një lloj *o*-je hundore me timbër të ndjeshëm.

Në ndonjë ligjërimit, si në atë të Grykës së Lumbardhit të Prizrenit e kemi më pak të shprehur, zakonisht të ndjekur edhe nga bashkëtingëlloret hundore *m, n, nj*, si për shembull: *shpejt, thê:ni shtagat//, vêni mirë rô:n//* etj.

Hundorësia dhe mungesa e saj, sikundër është theksuar edhe në studimet rreth fonetikës historike të shqipes, ka përfutur funksionin e kundërvënies së serive të zanoreve hundore me zanore gojore si dhe brenda vetë intensitetit të rezonancës hundore<sup>38</sup>. Seria e fonemave zanore hundore në arealet e të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinës ka edhe vlerë fonologjike. Pra, aty dallohen pesë zanore hundore të gjata: *â:, î:, ý:, ê: e û:* dhe po aq zanore hundore të shkurtra: *â, î, ý, ê e û*. Një numër i fjalëve mund të dallohen kuptimisht mbi bazën e gjatësisë, përkatësisht shkurtësisë së hundorësisë, si p.sh: *thî:* (thinjë) - *thî* (derr), *rê* (nusja e djalit) - *rê:* (vranësirë e motit), *kâ* (folje) - *kâ:* (emër) etj.

<sup>35</sup> Shih, P. Bogdani, “*Cuneus Prophetarum* (=“Çeta e profetëve”, Padovë, 1685).

<sup>36</sup> N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 27.

<sup>37</sup> I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2001, f. 44.

<sup>38</sup> E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Fonetika historike, Tiranë, 1976, f. 233.

Me rezonancë hundore, me sa duket si rezultat i analogjisë, dalin edhe fjalë që kanë prejardhje të huaj, por kanë pak intensitet, si: *insâ:n, Rahmâ:n, sejmên* etj.

Një çështje tjetër e këtyre zanoreve është edhe dukuria e humbjes apo e bjerres së hundorësisë (që mund ta quajmë edhe proces i çundurëzimit), si në rastet: *nanën, sanën*. Dobësimi i rezonancës hundore është shënuar në të folmen e qytetit të Prizrenit, në të folmen e Hasit: *dyćan, pishman, takam, imam* në të folmen e Vërrinit të Malësisë (Shtrungë) etj.

**3. Fonema bashkëtingëllore /h/** Në këtë areal ruhet mirë në të gjitha pozicionet, si në fillim fjale, ashtu edhe në mes e në pozicion fundor, si p.sh. *ha, duhani, lahm, krahi, kraht*. Pra, gjendja është e njëjtë me pjesën më të madhe të izoglosave të ADGJSH-së e që përfshijnë jo vetëm gegërishten, po edhe një pjesë të mirë të toskërishtes, sidomos të toskërishtes jugore, madje edhe të diasporës arbëreshe e arvanite.<sup>39</sup>

**4. Ruajtja e dallimit ndërmjet fonemave /r/ njëdridhëse dhe /rr/ shumëdridhëse.** Ashtu si pothuajse krejt të folmet e gegërishtes dhe një pjesë e madhe e të folmeve toske e ruan dallimin e dy fonemave /r/-/rr/, jo vetëm në rastet e *rue-rrue*, që paraqitet në ADGJSH, po edhe në të tjera të shumta si *ara-arra, her-herr*.

**5. Areali i Prizrenit me rrethinë hyn në izoglosën ruajtëse edhe të dallimit të fonemave /l/ e /ll/, duke pasur edhe çifte minimale të mundshme për diferencimin e tyre, si mali-malli, mola-molla, lava-llava, pu:l-pu:ll, si dhe vlla:-ba:ll, llu:g-bull, di:ll-dyll, ashtu si në hartën e ADGJSH-së, nr. 23, f. 91.**

**6. Situatë të njëjtë ka në këtë areal edhe për fonemat bashkëtingëllore /th/ e /dh/, të cilat janë të dallueshme e të identifikueshme me shembujt e njëjtë me ata që janë paraqitur në hartat nr. 24 e 25 të ADGJSH-së (*thi, dhi*), po edhe me plot të tjerë që ne i kemi verifikuar në anketimet e bëra në terren, si *edhe, erdha, udha; thika, thana, thekna*.**

**7. Një situatë të dallueshme nga pjesa më e madhe e të folmeve të shqipes, jo vetëm të toskërishtes, po edhe të gegërishtes jugore e, madje, edhe të asaj veriperëndimore, përbën shqiptimi i fonemave bashkëtingëllore ç e xh në fjalë të tipit çaj, oxhak dhe q e gj në fjalë të tipit qafë, gjak të cilat, në arealin e Prizrenit, ashtu si edhe në gati të gjitha pikat e anketuara në Atlas në anët e shqipes verilindore, kanë një realizim fonetik të dallueshëm, afërsisht si /tç/ e /dž/ p.sh. *vittç, odžak, tçafa, džak*<sup>40</sup>**

Edhe nga anketimet tona na del se në këto të folme fonemat *q* e *gj* nuk ruhen, ato kanë kaluar në afrikatet ç e xh, si në të folmen e Hasit, atë të Kabashit e atë të Anadrinit: *çyçe, çen, xharpën, brixhe* etj. Ruhen mirë në të

<sup>39</sup> Shih edhe: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 8, harta 21f. 89.

<sup>40</sup> Shih edhe: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, 12a dhe 12 b, harta 24 f. 94 dhe dukuria 13a dhe 13 b, harta 27, f. 95

folmet e rrethinës së Prishtinës, në të folmen e trevës së Bujanovcit, si dhe në atë të së folmes së Opojës.

Megjithëkëtë hetohet paqartësi, përkatësisht vështirësi e dallimit të kufirit të qartë deri te nuanca e përcaktimit të këtyre fonemave<sup>41</sup>. Për këtë dukuri në shtrirje të ndryshme territoriale, dialektologët që janë marrë me përshkrimin e të folmeve të caktuara e kanë hetuar me përparësi<sup>42</sup> e madje, akad. I Ajeti, e përkufizon të kryer në këto të folme në fund të shekullit të kaluar.<sup>43</sup> Për të pasur një pasqyrë reale të këtij problemi, patjetër duhet aplikuar metodën e eksperimentimit, përndryshe çdo shpjegim s'mund t'i shpëtojë lajthimit, sikundër shprehet me të drejtë I. Badallaj, i cili në studimin për këto qiellzore të trevës së Hasit, do të shtojë: "...mendimi ynë, i bazuar në materialin e eksploruar në terren është se ekzistojnë një palë okluzivësh palatale-afrikate, duke iu afruar më tepër afrikateve e më pak palataleve themelore".<sup>44</sup>

**8. Grupi i bashkëtingëlloreve /mb/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të gegërishtes, ku ky grup nuk ruhet si i tillë, por asimilohet në *m*, në disa pika edhe në *b* ose *p*. Në anketimet për Atlasin janë ndjekur shembuj *mbiell*, *kumbull*, *thumb*. Në punimin tonë, për këtë dukuri, kemi ndjekur po ata shembuj, si dhe të tjerë të së njëjtës dukuri dhe na rezulton se grupi /mb/ kryesisht thjeshtohet në një element, si p.sh.: *mjell* (<mbjell), *kumëll* (<kumbull), *thum* (<thumb); *mush* (*mbush*). Pra, situata është e njëjtë me sa është paraqitur në ADGJSH (dukuria 16, harta 31, f. 99).**

**9. Grupi i bashkëtingëlloreve /nd/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të gegërishtes, ku ky grup nuk ruhet si i tillë, por asimilohet në *η*, në disa pika edhe në *d* ose *t*. Në anketimet për Atlasin janë ndjekur shembuj *nder*, *këndoj*, *shkund*. Në punimin tonë kemi hetuar edhe shembuj të tjerë, ku grupi *nd* kalon në *η*: *ηal*(ndal) *ηryshe* (ndryshe), *aηena* (andena) dhe nuk kemi ndeshur raste të ruajtjes së këtij grupi, që, përkundrazi, del se ruhet në pikën nr. 28 që i përket Pejës në Lugun e Baranit.<sup>45</sup> Natyrisht, në kohët e sotme, grupi **nd**, ashtu si dhe grupi **mb**, ka marrë shtrirje e po përhapet edhe nën ndikimin e shqipes standarde, sidomos nëpërmjet botimeve të shkruara, po edhe nga e folura e mjedisëve më të ngritura nga ana arsimore e kulturore.**

<sup>41</sup> L. Mulaku - M. Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, I, GJASSHF, II, 1972, Prishtinë, f. 87.

<sup>42</sup> F. Raka, *E folmja e qytezës së Kaçanikut*, SGJ, (D), Prishtinë, 1978, f. 503.

<sup>43</sup> Shih, I. Ajeti, Pamje historike e ligjërimit shqip të Gjakovës, shekulli XIX", Prishtinë, 1985, Prishtinë, 1978, f. 71).

<sup>44</sup> Shih, I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005, f. 154.

<sup>45</sup> Shih: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 17, harta 32, f. 100.

**10. Grupi i bashkëtingëlloreve /ng/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të gegërishtes, ku ky grup nuk ruhet si i tillë, por asimilohet në **ŋ**, në disa pika edhe në **g** ose **k**. Areali i Prizreni me rrethinë, ashtu si shumica e të folmeve të gegërishtes e ka këtë fonemë, në fjalë si *ŋusht*, *kuŋull*, *lanj*, duke u përfshirë në izoglosën më të hapët të arealit të gegërishtes e, natyrisht, duke u dalluar dukshëm nga të folmet e toskërishtes, si dhe nga disa të folme të gegërishtes veriore, kryesisht veriperëndimore, ku kjo fonemë nuk ekziston.<sup>46</sup> Në anketimet për Atlasin janë ndjekur shembuj *ŋushtë* (ngushtë), *kuŋull* (kungull), *truŋ* (trung), *cunj* (cung). Në punimin tonë kemi hetuar edhe shembuj të tjerë *hâ<sup>o</sup>ŋra* (hëngra), *shllûŋ* (shtëllungë); për *g*: *gu:tu* (ngutu); për *k*: *kanîher* (nganjëherë), *kadale* (ngadalë) etj. *hâ<sup>o</sup>ŋra* (hëngra), *shllûŋ* (shtëllungë) dhe situata del e njëjtë me izoglosën përkatëse të Atlasit.**

**11. Grupi i bashkëtingëlloreve /ngj/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të gegërishtes verilindore, ku ky grup ruhet si i tillë, duke u dalluar kështu qartë nga të folmet e gegërishtes veriperëndimore dhe ato të Shqipërisë së mesme, pra, duke na dalë me një situatë të njëjtë me arealin e toskërishtes<sup>47</sup>. Në punimin tonë kemi hetuar edhe shembuj të tjerë dhe në këtë aspekt është për t'u evidentuar se grupi bashkëtingëllor **ngj** del i plotë: *ngjyj* (<ngjyeyj), *ngjesh*, *ngjall*.**

**12. Grupet e bashkëtingëlloreve /tj/ dhe /dj/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të mbarë shqipes, ku ato grupe ekzistojnë si të tillë. Krahas fjalëve *tjerr*, *i djathtë* që janë anketuar për Atlasin, ne kemi ndjekur edhe të tjera të së njëjtës kategori, si *tjegull*, *tjetër*, *djathi*, *dje*, që dëshmojnë se ky grup ruhet si i tillë, njësoj si në mbarë shqipen<sup>48</sup>, në një numër të vogël fjalësh e ndeshim edhe të asimiluar: *çetër*, *çetri*, *çer*, për *tjetri*, *tjerë*, *tjetër*.<sup>49</sup>**

**13. Grupi i bashkëtingëlloreve /mj/. Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të mbarë shqipes, ku ato grupe ekzistojnë si të tillë. Shembujve *mjekër*, *mjaltë*, që jepen në hartën përkatëse të Atlasit<sup>50</sup>, në trevën tonë të së folmes së Hasit u përgjigjen: *mjekërr*, *mjel*<sup>51</sup>, si dhe, nga anketimet tona në arealin e të folmes së Grykës së Lumbardhit të Prizrenit me rrethinë, mund t'u bashkëngjisim edhe *mjalti*, *mjaft*,**

<sup>46</sup> Shih edhe: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 15a, harta 29, f. 97.

<sup>47</sup> Shih: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 19, harta 342, f. 102

<sup>48</sup> Shih: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 20, harta 35, f. 102.

<sup>49</sup> Shih, N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 131.

<sup>50</sup> Shih: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 21, harta 36, f. 104.

<sup>51</sup> Shih, I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005, f. 97.

*mjafton* etj. Në të folmen fqinje të këtyre arealeve, në folmen e Opojës ky grup del: *mjegoll, normjet, mjeshtor*<sup>52</sup> etj.

**14. Grupet e bashkëtingëlloreve /pl/ dhe /bl/.** Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën më të gjerë të mbarë shqipes: *plak ble*. ku ato grupe ekzistojnë si të tillë. Ruajtja dhe përdorimet janë si edhe në të folmet e tjera verilindore, krahas shembujve të identifikuar në izoglosën përkatëse të Atlasit<sup>53</sup>, ka shembuj që sadopak shquajnë nuanca të përfaqësojnë të folmet përkatëse, si për shembull: *plug*<sup>54</sup>, *plla:m, ple:m, plum*, por edhe *pllug*<sup>55</sup> *pluhon, shuplak* megjithëse shumica sosh janë si në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore: *plak, plep, plesht, pleç*<sup>56</sup>, *pleh, pleme, plis, pluhon* etj. Nga këndej del ruajtja e këtyre grupeve të bashkëtingëlloreve, *pl* e *bl*; *plak, plep, bluj, bli* në të folmen e Prizrenit dhe rrethinës, por shquhen të zhvilluara më tej në disa të folme, si atë të Dibrës, atë të Lumës<sup>57</sup> etj.

**15. Grupi e bashkëtingëlloreve /fsh/.** Areali i Prizrenit me rrethinë, në izoglosat e ADGJSH-së përfshihet në izoglosën e shqipes verilindore ku, nga fjalët me grupin **fsh** (kofshë, lafshë, mëndafsh), të anketuara për Atlasin, në pikat 34, 37, 38 mbahet si i tillë p.sh. kofshë, lafshë, mëndafsh, kurse në pikën 31 (Nishor) vetëm te fjala mënafsh /mundafsh<sup>58</sup>. Në të folmen fqinje të Opojës ka dhënë grupin *fç*, por është reduktuar në sh: *fçi (fshi), kofça (kofsha) me shi grunin*<sup>59</sup> etj.

Në rastin e grupit **fsh** te foljet e mënyrës dëshirore, grupi **fsh** ruhet i plotë dhe, kështu, e folmja e arealit të Prizrenit me rrethinë përkon plotësisht me pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes verilindore, po edhe të toskërishtes e të gegërishtes së Shqipërisë së Mesme, duke u dalluar kështu qartë vetëm nga të folmet e gegërishtes veriperëndimore dhe pjesërisht qendrore, ku grupi nuk ruhet. Pra, në arealin tonë kemi *punofsha, shkofsha, gzofofsha* etj. si dhe te emri *lafsha*.<sup>60</sup>

**16. Grupet e moçme kl e gl.** Në të folmet verilindore të shqipes, sikundër dihet, kanë përfunduar në bashkëtingëlloret *k* e *g* në fjalët: *kish, i gatë, kumësht < kjumësht*<sup>61</sup> (dhallë) etj. Format e hershme *kl* e *gl* deri në ditët e sotme

<sup>52</sup> Shih, N. Pajaziti, *E folmja e Opojës*, IAP, Prishtinë, 2005, f. 91.

<sup>53</sup> Shih: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 22a dhe 22b, harta 37, f. 105.

<sup>54</sup> Shih, I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005, f. 98.

<sup>55</sup> Shih, N. Pajaziti, *E folmja e Opojës*, IAP, Prishtinë, 2005, f. 91.

<sup>56</sup> Shih, F. Dulaj, *E folmja e Rahovecit me rrethinë*, Prishtinë, 2016, f. 142.

<sup>57</sup> Shih, J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 48.

<sup>58</sup> Shih: ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 23a harta 39, f. 107.

<sup>59</sup> Shih, N. Pajaziti, *E folmja e Opojës*, IAP, Prishtinë, 2005, f. 80.

<sup>60</sup> Shih, ADGJSH, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 23b harta 40, f. 108.

<sup>61</sup> Shih, L. Mulaku, *E folmja e Shalës së Bajgorës*, Prishtinë, 2005, f. 69.

janë ruajtur vetëm nga arbëreshët e Italisë<sup>62</sup>, në të folmen e çamërishtes si dhe në të folmet ruajtëse të arvanitëve, ku është mbajtur deri sot një gjendje e ngjashme me shqipen e hershme.

Në izoglosat e Atlasit janë hetuar e hartografuar rezultate për fjalën qenë, që në arealin tonë të Prizrenit me rrethinë, si dhe në mbarë të folmet verilindore del në formën kanë (*ishna kân, nuk jam kân*), kurse për **gl** janë hetuar fjalët *gju, zgjua, i gjatë*, të cilat, sikundër e cekëm, në arealin tonë dalin me **k, g**, përkat. *guni, gujt, i ga:t, e ga:t*.<sup>63</sup>

**17. Fonema /q/.** Areali i Prizrenit me rrethinë, bashkë me krejt të folmet e gegërishtes verilindore, përbëjnë një areal të dallueshëm nga të folmet e tjera të gegërishtes dhe nga toskërishtja, sepse fjalët *qime, qerre, liqen, qe, qep, qesh*, të anketuara për Atlasin, këtu dalin me /k/, përkatësisht: *kime, kerri, lkeni, ke, kep, kesh*.

**18. Togu i zanoreve ua.** Fati i evolucionit fonetik të grupit të hershëm **uo**, madje **ou**, është me interes të dorës së parë në studimet dialektologjike dhe për fonetikën historike të shqipes. Në fakt, për atë fenomen, të dhënat e izoglosave të ADGJSH-së janë shumë të rëndësishme dhe me vlerë edhe për njohjen e procesit të bashkëveprimit ndër dialektor të sotëm me standardin e shqipes.

Fjalët e anketuara për Atlasin kanë qenë: *duar, muaj, bualli*, si dhe *grua,ftua, dua*, këto fjalë, si në hartat e Atlasit, sipas anketimeve të bëra nga autorët, ashtu edhe në hetimet për studimin tonë për të folmen e Prizrenit me rrethinë na dalin me **-ue**. Pra, kemi përkatësisht: *duer, muej, buelli*, si dhe *grue, ftue, due; grueja, buelli, shkruke*.<sup>64</sup>

**19. Togu i zanoreve /ue/.** Fjalët e anketuara për Atlasin kanë qenë *mësues, sulmues*. Ashtu si në anketimet dhe në hartën përkatëse të ADGJSH-së, edhe në anketimet tona dalin me **-ue**: *mësues, mësuese, punues, punuese*.

**20.** Në kuadër të dallimeve të dialekteve të shqipes shquhet fonema zanore/ë/. Në këto të folme si edhe në mbarë dialektin e gegërishtes<sup>65</sup> këtë zanore e hasim të reduktuar ose edhe të paspikatur në të shqiptuarit e rrokjes së fjalës. **Zanorja /ë/fundore**, që dikur gjendej në rrokjen e hapur, sot nuk dëgjohet në ligjërimet e këtyre arealeve, si p.sh.: *mo:ll, fush, do ta bajn* etj. Zanorja e patheksuar ka rënë në të gjitha rrokjet fundore, përveç kur ndiqen nga

<sup>62</sup> E. Çabej, *Për historinë e konsonantizmit të gjuhës shqipe*, "Studime rreth historisë së gjuhës shqipe", Tiranë, 1973, f. 149.

<sup>63</sup> Shih: *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 59a dhe 59b harta 122 dhe 123, f. 190-191.

<sup>64</sup> *ADGJSH*, Vëllimi I, Fonetikë, dukuria 51a dhe 51b harta, 51 c, hartat 102, 103 dhe 104, f. 170-171-172.

<sup>65</sup> L. Mulaku - M. Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, I, GJASSHF II-1972, Prishtinë, 1974, f. 87.

bashkëtingëlloret: *i, ll, r, rr, m, e n*: *gogël, motër, kokërr, dimën, i pashëm*<sup>66</sup> etj. Zhdukja e *ë-së* fundore ka sjellë gjatësinë e zanores së theksuar të fjalës.

Pastaj janë me rëndësi edhe ndërrime të *ë-së* në *i* që janë përftuar nga reduktimi i fonemës *a* në *ë*, si te foljet e zgjedhimit të parë: *livroj (lëvroj), livdoj (lëvdoj), gjimoj (gjëmoj)*. Në të folmen e Kabashit e atë Anadrinit, *ë*-ja e patheksuar kalon në fonemën *u* si për shembull: *dasum, i vetun, i moçun* etj. Gjithashtu në krahasim me të folmen e qytetit të Gjakovës: *purçik-përçik*, në të folmen e Anadrini<sup>67</sup>t: *dasum, -dasëm, i dishum-i dishëm, i pashum-i pashëm* etj. Sikur edhe në të folme fqinje<sup>68</sup> janë shënuar kalime të kësaj zanoreje: *ë>a: miqasi (miqësi), mardhi (mërdhi), kaçik (kërçik); ë>y: dinsyz (dinsëz), edepsëz (edepsëz); të a-së në o: llagam<llagom, takam <takom, azgan<azgon etj.*

**Përfundim.** Studimet për varietetet e dialekteve, siç janë këto të arealeve të të folmeve të qytetit të Prizrenit dhe rrethinave së tij, në kuadër të varieteteve të të folmeve verilindore të gegërishtes, marrë në përgjithësi, kanë rëndësinë e tyre, madje ne do të thoshim të pazëvendësueshme për kundrimin e zhvillimeve të gjuhës së sotme dhe posaçërisht për historinë e dialektologjisë dhe të historisë së gjuhës sonë, duke qenë se ky areal është pjesë e kësaj tërësie që i bie të jetë pikërisht në qendër të trojeve të gegërishtes verilindore. Rezultatet e përnjohjeve dialektore kanë vlera të veçanta dhe për pasurimin e gjuhës, ngase gjuha e folur popullore, përkatësisht varietetet e saj janë burim i pashtershëm fjalësh e shprehjesh për komunikim më të ndjeshëm e gjithashtu edhe për rritje e ngritje të përhershme të ndër marrëdhënieve shoqërore e gjuhësore. Në radhë të parë këtu kemi parasysh elementet e përbashkëta e thelbësore të bazës së mbrytjes së përbërjes së gjuhës standarde që pothuajse i shënon të gjitha sferat e saj. Po kështu edhe në pjesën më të madhe të këtyre të folmeve këto karakteristika janë të përafërta sikurse edhe për të gjitha varietetet e të folmeve të shqipes.

## BIBLIOGRAFI

- Agani, H., *Disa veçori tingullore që e ka e folmja e Gjakovës (qytet)*, PP, SHLP, Prishtinë, 1969.  
 Agani, H., *Ë-ja në qytetin e Gjakovës*, DSH V, Tiranë, 1987.  
 Ajeti, I., *Dokumenti më i vjetër i së folmes shqipe të Kosovës me alfabet arab*, I-1962, Prishtinë, 1962.

<sup>66</sup> Shih, I. Badallaj, *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005, f. 61.

<sup>67</sup> Shih, N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, Prishtinë, 2008, f. 71.

<sup>68</sup> H. Kelmendi, *E folmja e lokalitetit të Turiçevcit*, GJASSHF, VI-1976, Prishtinë, 1978, f. 121.

- Ajeti, I., *Rreth disa veçorive të të folmeve... të Preshevës dhe të Bujanovcit*, GJA, 2-1969, Prishtinë, 1969.
- Ajeti, I., *Gjuha e Divanit të Sheh Maliqit*, Vepra 2, Prishtinë, 1998.
- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Vëllimi I, Napoli, 2007, Vëllimi II, Napoli 2008.
- Beci, B., *Të folmet lindore të gegërishtes veriore*, DSH, IV, Tiranë, 1987.
- Beci, B., *Gegërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1987/3.
- Bardhi, M., *Disa veçori karakteristike në vokalizimin e së folmes së Hasit*, SGJ, II, (D), Prishtinë, 1979.
- Badallaj, I., *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, GJASSHF, V-1975, Prishtinë. 1976.
- Badallaj, I., *E folmja e Hasit*, Prishtinë, 2005.
- Bardhi, M. - MULAKU, L., *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, II, GJA, III, 1973, Prishtinë, 1974.
- Çabej, E., *Për nazalizmin në gjuhën shqipe dhe në gjuhët indoevropiane*, SGJ, Prishtinë, 1976.
- Çabej, E., *Për historinë e konsonantizmit në gjuhën shqipe*, në “Studime rreth historisë së gjuhës shqipe”, Tiranë, 1973.
- Çeliku, M., *Kuantiteti i zanoreve të theksuara në të folmet e shqipes*, “Studime filologjike”, Tiranë, 1971/4.
- Çeliku, M., *Vëzhgim mbi grupin e të folmeve të gegërishtes ...*, KDSA, 12-18 janar 1968, Tiranë, 1969.
- Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*, ETMMK, Prishtinë, 1970 (Tiranë, 1975).
- Gjinari, J., *Për zhvillim e grupeve kl e gl në të folmen e gjuhës shqipe*, GJASSHF, I-1971, Prishtinë, 1972.
- Halimi, M., *Kërkime dialektologjike*, Prishtinë, 1985.
- Shkurtaj, Gj., *Dialektet e shqipes*, Tiranë, 2012.
- Shkurtaj, Gj., *Shënime për të folmen arbëreshe të San Marcanos*, SF, I, Tiranë, 1979.
- Shkurtaj, Gj., *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHB, LSH, Tiranë, 2004.
- Topalli, K., *Zhvillimi historik i diftongjeve të shqipes*, Toena, Tiranë, 1998.
- Topalli, M., *Sistemi fonetik i të folmes shqipe të qytetit të Prizrenit*, FF, Prishtinë, 1980.
- Topçiu, V., *Veçoritë fonetike të së folmes së elementit katolik të qytetit të Prizrenit*, FF, Prishtinë, 1978.
- Zymeri, A., *Vëzhgime mbi të folmen e Opojës-Morfologji e leksik*, GJA, V-1975, Prishtinë, 1976.
- Zymeri, A., *Sistemi foljor në të folmen e fshatit Struzhë të Malësisë së Prizrenit*, Prishtinë, 1978.

## **SUMMARY**

### **ABOUT SOME PHONETIC PHENOMENA OF THE SPOKEN LANGUAGE IN PRIZREN WITH THE SURROUNDINGS**

Studies of dialect varieties such as those of dialects of the city of Prizren and its surroundings, within the varieties of the dialects of the northeast dialect generally have their significance, even we would say irreplaceable for opposing today's language developments, and especially for the history of dialectology and the history of our language, as this area is part of this whole that falls precisely at the center of the lands of northeastern Gheg. The results of dialectic recognition have special value for the enrichment of the language, as the popular specter language, its varieties are an inexhaustible source of words and expressions for more sensitive communication as well as for the permanent growth and enhancement of interpersonal relations and language.

First and foremost, we have in our mind the common and essential elements of the standard, language composition base that marks almost all of its spheres. Likewise in most of the spoken language these characteristics are similar to those of all varieties of Albanian spoken language.